



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 40005-15721
Dt: 07.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, si dhe dispozitave të Rregullores me Nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, duke vendosur sipas vendimit të Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e Rinisë, me datën 07.08.2023 merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve sipas Vendimit të Komisionit Vlerësues për fushën e Rinisë.
2. Pjesë e këtij Vendimi është lista në fushën e Rinisë sipas nr. prot.10/660/01-131379 e dt.30.06.2023.
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizoj procedurën e zotimit të mjeteve financiare për OJQ-të përfituese, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në xhirollogaritë e OJQ-ve Rinore sipas pikës së dytë të këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës.
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- OJQ-ve Rinore.
- Arkivit.

Ardian Gjini


Kryetari i Komunës së Gjakovës

1. Lista e OJQ-ve në fushën e Rinisë:

NR.	Emri i OJQ-së	Emri i Projektit	Vlerat:	Xhirollogaritë Bankare
1	YMCA-Lëvizje	“Camp Climate”	3,000	1117007312000188 PCB
2	Activism Root’s	“Aktivizohu Rini”	2,700	1930007108031103 BKT
3	BONEVET	“Zhvillimi i kapaciteteve dhe vetëdijesimi i Rinisë për Punë dhe Angazhim”	3,300	1501150001427619 RZB
4	OJQ ”Rogova”	Masivizimi i Rinisë në Luftë kundër dukurive negative me theks të veçantë “Narkomani” dhe “Bullizmi	1,000	1401000014449978 BEK



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Bazuar në nenin 16 paragrafi 3,4,5 dhe nenit 20 të Rregullores Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve gjithashtu, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjakovës me nr. 01Nr.112-02-11183 të datës: 30.05.2023 për themelimin e Komisionit Vlerësues sipas Thirrjes Publike në fushën e RINISË, Komisioni Vlerësues me datë: 29.06.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1.Komisioni duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 3,4,5 dhe nenit 20 të Rregullores Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve nxjerr vendim për OJQ-të Kultureore dhe OJQ-të/Klubet Sportive të cilat i kanë plotësuar kriteret sipas Thirrjes Publike nr.10-113/01-9355 të datës: 08.05.2023 për realizimin e projekteve, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë.

2.Shpenzimi i mjeteve lejohet për realizimin e projekteve/programmeve të aprovuara sipas fushave përkatëse të OJQ-ve përfituese si në vijim:

2.1 Fusha e Rinisë:

NR.	Emri i OJQ-së	Emri i Projektit:	Vlerat:
1.	OJQ "Rogova"	Masivizimi i Rinisë në Luftë kundër dukurive negative me theks të veçantë "Narkomani" dhe "Bullizmi"	1,000
2.	Activism Root's	"Aktivizohu Rini"	2,700
3.	YMCA	"Camp Climate"	3,000
4.	BONEVET	"Zhvillimi i kapaciteteve dhe vetëdijesimi i Rinisë për Punë dhe Angazhim"	3,300


3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Komisionit.

Vendimi ju dërgohet:


- Zyrës së Kryetarit.
- DKRS.
- OJQ-ve përfituese.
- Arkivit.

Komisioni Vlerësues:

1. Urim Fazlija (DKRS) - Kryesues
2. Drenusha Hoxha (DKRS) - anëtare
3. Pylljon Nura (Ekspert i jashtëm) - anëtar
4. Shpresa Karaxha (përfq.e OJQ) - anëtare
5. Devoll Kërleshi - anëtar



DHoxha



Karaxha
